



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 677/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaçi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Subjektit Politik Lista e Pavarur Bekim Jashari, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës, për shkak të presionit ndaj votuesve, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 21.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.677/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga Lista e Pavarur Bekim Jashari, kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës, për shkak të presionit ndaj votuesve.

A r s y e t i m

Me datë 18.10.2021, PZAP, ka pranuar ankesë nga Lista e Pavarur Bekim Jashari kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës ku thuhet se në qendrat e votimit, përkatësisht në fshatin Likoc QV 2103B, fshatin Klinë e Epërme QV 2106B, fshatin Vojnik QV 2110B, fshatin Kllobërnice QV 2112B, fshatin Llaushë QV 2115B, fshatin Makërmal QV 2112B dhe fshatin Ternac QV 2127B, gjate tërë procesit së votimit janë parë qytetar të grumbulluar para shkollave të cilët kanë bërë presion qytetarëve për të votuar për PDK-në, gjë që flet për parregullsi të procesit zgjedhor prandaj kërkojnë rivotim me këtë ankesë. Si dëshmi kanë bashkangjitur fotografi te bëra nga qytetaret ku shihet edhe deputeti i PDK-se Mërgim Lushtaku.

PZAP-i me datë 19.10.2021 i ka dërguar Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) kërkesë për përgjigje në ankesë dhe Policisë së Kosovës – kërkesë për raport lidhur me mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në Qendrat e Votimit të cituara në ankesë.

Në përgjigje në ankesë të datës 19.10.2021, Partia Demokratike e Kosovës deklaroi se ankesa është e pa bazuar për arsye se Ligji Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës i zbatueshme edhe në zgjedhjet lokale, dhe Rregulla Zgjedhore Nr.11/2013 për Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatet si dhe Rregulla Zgjedhore Nr.13/2013 “Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike, në asnjë dispozite të tyre, nuk e përcaktojnë fare rrethanën kur jashtë qendrave të votimit, mund të shihen njerëz. Kjo për faktin se ligjvënësi nuk ka paraparë ndonjë situatë hipotetike, apo te paragjykoj qëllimin e personave nëse janë në radhë për të votuar apo jo. Ankuesi pa asnjë provë pretendon se para qendrave të votimit iu është bërë presion votuesve për ta votuar PDK-në sepse në këto vendvotime procesi është evidentuar si i rregullt sipas procesverbaleve të hartuara dhe nënshkruara nga kryesuesi dhe anëtarët e komisionit që kanë administruar procesin. Me propozim që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjithashtu sipas kërkesës së PZAP-it, Policia e Kosovës me datë 19.10.2021, ka dërguar raportin policor lidhur me mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në qendrat e votimit, përkatësisht në fshatin Likoc QV 2103B, fshatin Klinë e Epërme QV 2106B, fshatin Vojnik QV 2110B, fshatin Llaushë QV 2115B, fshatin Makërmal QV 2112B dhe fshatin Terrnac QV 2127B, ku theksohet se Policia e Kosovës përkatësisht zyrtaret e saj kanë qenë gjatë tërë kohës në këto qendra dhe nuk ka evidentuar ndonjë pa rregullsi, përveç në fshatin Kllobërnice QV 2112B, është hapur një rast për cenim të fshehtësisë së votimit, e që konsiston me lokacionin në foton 1 dhe 2 të ankesës.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se së në ditën në qendrat e votimit te cekura në ankesë ka pasur presion ndaj votuesve për të votuar Subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës, paneli gjeti se këto pretendime janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi pasi që nga fotografit që gjenden në shkresat e lëndës nuk shihet ndonjë llogo, shenjë e Subjektit politik PDK, nuk është identifikuar ndonjë anëtar apo mbështetës i këtij subjekti me të cilën do të vërtetohej se të njëjtit janë duke bërë presion ndaj votueseve apo fushatë zgjedhore.

Nga Raporti i Policisë së Kosovës lidhur me rastin e hapur në fshatin Killobërmic QV 2112B, ku thuhet se është hapur një rast për cenim të fshehtësisë së votimit, paneli për këtë raport nuk mundi ta vërtetoj se e njëjta ka ndërlidhje me pretendimet e ankuesit pasi që në raport nuk identifikohet asnjë person, se kush janë të njëjtit apo të cilit subjekt politik janë anëtarë. Gjithashtu ne raportin policor përmendet se është iniciuar rast për cenim të fshehtësisë së votimit kurse ne ankesë pretendohet se ka pasur presion ndaj votuesve.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Lista e Pavarur – Bekim Jashari, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, ku thuhet se “Vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.” pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje në procesin e votimit me datën 17.10.2021, në Qendrat e Votimit të parashtruara në ankesë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.677/2021 më datën 21.10.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.